



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

VENDIM

PER
NXERRJEN JASHTE PERDORIMIT TE AKTIVEVE DHE MATERIALEVE
TE TJERA NE BASHKINE VAU DEJES DHE NJESITE
ADMINISTRATIVE TE BASHKISE
Nr. 35, Datë 02/06/2016


Bazuar në Ligjin nr. 139/2015, "Për vetqeverisjen vendore", neni 54 pika "dh", neni 55 pika 3, pika 6; Ligji nr. 115/2014 "Për ndarjen administrative-territoriale të njëjësive të njëjësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë; Ligjin Nr.112/2015, "Për inspektimin financiar publik", i ndryshuar; Ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"; Manualin për menaxhimin financiar dhe ekuilibrin të miratuar me urdhërin e MF Nr.8980, datë 15.07.2010; Ligjin Nr. 10296, datë 08. 07. 2010 "Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"; Ligjin Nr 9936, datë 26. 06. 2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne RSH"; Ligjin Nr. 9367, datë 07. 04. 2005 "Per parandalimin e konfliktit te interesave ne ushtrimin e funksioneve publike"; Udhezimin e Ministrise se Financave Nr. 30, date 27. 12. 2011 "Per menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publik", neni 109, neni 120 i ndryshuar, Keshilli Bashkiak pas shqyrtimit te te gjithë materialit që nga inventarizimi, vlerësimi e deri tek relacioni i paraqitur nga komisioni i nxerrjes jashtë përdorimit të aktiveve, me shumicë të cilësuar votash:

VENDOSI:

1.Të miratojë listën e materialeve të nxjerra jashtë përdorimit në shumën 29,342,678 (njëzet e nëntë milion e treqind e dyzet e dy mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë, sipas llogarisë kontabel si më poshtë:

Llogaria	Emertimi	Jashte Perdorimit Vlera leke
214	Instalime tek. Mak. e vegla pune	1,478,400
215	Mjete transporti	9,102,709
218	Inventar ekonomik	17,384,824
327	Inventari imet	1,376,745
	SHUMA	29,342,678

Bashkëngjitur lista e detajuar për secilën llogari ekonomike.



Të ndiqen procedurat e nevojshme sipas Udhezimit te Ministrise se Financave Nr. 30, date 27. 12. 2011

"Per menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publik" , i ndryshuar, sipas llojit të materialeve të nxjerra jashtë përdorimi. Mjetet e transportit të hiqen nga rregjistri i aktiveve në përdorim, të bëhen hyrje në magazinë (rikupero), dhe tu shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 pika 6 të ligjit 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”.

4. Ky vendim u shpall me datë 10.06/2016.

SEKRETARI

Gentian Ndoj



KRYETARI

Martin Marku